

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7944
E mërkurë, 4 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit për sulmin në Zubin Potok



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KAMBERI: SERBIA VAZHDON T'I SHKELË TË DREJTAT E SHQIPTARËVE NË LUGINË

FAQE 4-5



Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka akuzuar Beogradin zyrtar për shkelje të vazhdueshme të të drejtave në Luginë të Preshevës. "Në raport me shqiptarët, Serbia është injoruese ndaj rekomandimeve

të BE-së. Kur është fjala për respektimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, Serbia nuk përfillë as rekomandimet që vijnë nga Brukseli. Në Raportin e Progresit të Serbisë për vitin 2024, në kapitullin për të

drejtat e pakicave, Komisioni Evropian, veç çështjes së pasivizimit, gjuhës së urretjes, theks të veçantë vë edhe në pozitën e nënpërfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike dhe polici", ka thënë Kamberi

PSE FLITET TASH PËR FSK-në NË VERI?

F. 5



AKUZA NDAJ SISTEMIT TË DREJTËSISË, KËSHILLI PROKURORIAL I REAGON KRYEMINISTRIT KURTI F. 5



OPINION

PREKAZI, VARRAGA DHE UKRAINA! F. 5

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



NATO-ja: DO T'I RRSIM PËRPPJEKJET PËR T'IU KUNDËRVËNË AKTEVE SABOTUESE TË RUSISË DHE KINËS F. 2

VDIQ GAZETARI ZIJADIN GASHI F. 6

EKONOMI



ADMINISTRATA TATIMORE: 883.6 MILIONË EURO TATIME TË MBLEDHURA PËR 11 MUAJ F. 8

SIPËRFAQJA E PUNUAR E TOKËS DHE E BPV-SË JANË RRRITUR PËR 50 PËR QIND F. 8

SPORT



SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE NË KUPËN E BASKETBOLLIT F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NATO-ja: Do t'i rrisim përpjekjet për t'iu kundërvënë akteve sabotuese të Rosisë dhe Kinës

BRUKSEL, 3 DHJETOR - NATO do ta rrisë ndarjen e inteligjencës dhe do ta përmirësojë mbrojtjen e infrastrukturës kritike në dritë të akteve "armiçesore" të sabotimit që vijnë nga Rusia dhe Kina, tha shefi i aleancës ushtarake perëndimore, Mark Rutte. "Në vitet e fundit Rusia dhe Kina kanë tentuar t'i destabilizojnë shtetet tona [anëtarët e NATO-s] me akte të sabotimit, sulme kibernetike, dezinformata dhe kanë përdorur shantazh energjetik për të na frikësuar", tha Rutte për gazetarët më 3 dhjetor. "Aleatët e NATO-s do të vazhdojnë të qëndrojnë së bashku në dritë të këtyre kërcënimeve përmes një sërë masash, përfshirë ndarjen më

të madhe të inteligjencës dhe mbrojtjes më të mirë të infrastrukturës kritike", shtoi ai.

Ministrat e Jashtëm të NATO-s takohen në Bruksel këtë javë dhe pritet të dalin me një strategji të re për t'u përballur me kërcënimet hibride - term që përfshin propagandën, ndërhyrjen politike, sabotimin e infrastrukturës kritike dhe taktika të tjera që shkojnë përtej domenit konvencional ushtarak.

Zyrtarët perëndimorë të sigurisë kanë thënë se zjarret në depo të kompanive të transportit në Britani, Gjermani dhe Poloni në korrik ishin pjesë e një komploti rus për të shkakuar shpërthime në



transportin ajror të mallrave për në Shtetet e Bashkuara.

Shtetet evropiane, ndërkaq, po vazhdojnë të hetojnë nëse

këputja e dy kablove optike të telekomunikimit në Detin Baltik në nëntor ishte akt i sabotimit. Një nga kabllo lidh Finlandën me Gjermaninë, ndërkaq tjetra Suedinë me Lituaniën.

Rusia vazhdimisht ka hedhur poshtë akuzat se përfshihet në akte hibride.

Kina, po ashtu, ka hedhur poshtë akuzat se qëndron pas një sulmi kibernetik nga një agjencie qeveritare gjermane më 2021.

Zyrtarët perëndimorë kanë thënë se NATO-ja përballet me sfida se si t'u përgjigjet sulmeve të dyshuara, pasi disa anëtarë të aleancës kanë frikë se mund të përshkallëzohen tensionet me Rusinë.

Hamasi dhe Fatahu, afër marrëveshjes për qeverisjen e Gazës pas luftës

GAZA, 3 DHJETOR - Zyrtarët palestinezë thanë se Fatahu dhe Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - janë afër arritjes së një marrëveshjeje për caktimin e një komiteti politik të teknokratëve të pavarur për të administruar me Rripin e Gazës pasi të përfundojë lufta.

Nëse arrihet një marrëveshje e tillë, atëherë në mënyrë efektive do t'i jepte fund sundimit të Hamasit në Gazë dhe do të mund të ndihmonte në avancimin e bisedimeve për armëpushim me Izraelin. Fraksionet rivale kanë bërë disa tentime të dështuara për t'u pajtuar që kur Hamasi mori pushtetin në Gazë më 2007. Izraeli, ndërkaq, ka hedhur poshtë mundësinë që Hamasi apo Fatahu të kenë ndonjë rol në Gazën e pasluftës.

Fatahu dominon në Autoritetin Palestinez, që mbështetet nga Perëndimi. Një zyrtar i Autoritetit Palestinez konfirmoi më 3



dhjetor se një marrëveshje është arritur pas bisedimeve disajavore në Kajro. Zyrtari tha se komiteti do të kishte 12-15 anëtarë, shumica nga ta nga Gaza.

Ky komitet do t'i raportonte Autoritetit Palestinez, i cili ka selinë në Bregun e pushtuar Perëndimor, dhe do të punonte me palët lokale dhe ndërkombëtare për ta

lehtësuar ndihmën humanitare dhe rindërtimin e Gazës.

Një zyrtar i Hamasit tha se grupi radikal dhe Fatahu janë pajtuar për termat e përgjithshëm, por ende po negociojnë për disa detaje dhe për individët që do të ishin pjesë e komitetit. Ky zyrtar tha se marrëveshja do të bëhet publike pas një takimi të të

gjitha fraksioneve palestineze në Kajro, pa dhënë një afat se kur do të mund të ndodhë kjo. Dy zyrtarët folën në kushte anonimiteti, pasi nuk ishin të autorizuar që të flisnin me gazetarët për këto negociata. Izraeli ende nuk ka reaguar për këto raportime.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu është zotuar se shteti i tij do të vazhdojë luftën në Gazë derisa Hamasi të zhbëhet dhe dhjetëra pengje të lirohen. Ai ka thënë se Izraeli do të mbajë për një afat të pacaktuar kontrollin e Gazës, teksa çështjet civile do të administrohen nga palestinezët që nuk janë të lidhur me Autoritetin Palestinez apo Hamasin.

ShBA-ja ka bërë thirrje për revitalizimin e Autoritetit Palestinez në mënyrë që të qeverisë Bregun Perëndimor dhe Gazën para formimit të një shteti të mundshëm. Qeveria izraelite, që kundërshton një shtet palestinez, raportohet se ka diskutuar për planet e pas luftës me Emiratet e

Bashkuara Arabe, me të cilën ka normalizuar raportet më 2020. Emiratet mbështesin një fraksion rival të Fatahut.

Zyrtari i Hamasit tha se marrëveshja do të përmbushte një nga qëllimet e luftës të Izraelit, që është dhënia fund e sundimit të Hamasit në Gazë.

Autoriteti Palestinez, që administron pjesë të Bregut Perëndimor, njeh Izraelin dhe bashkëpunon për çështje të sigurisë, një politikë që nuk është popullore në mesin e palestinezëve, pasi shumë prej tyre e shohin si ndihmë të pushtimit.

Lufta në Gazë nisi në tetor të vitit 2023, pasi Hamasi sulmoi Izraelin, duke vrarë afër 1 200 persona - shumica civilë - dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Edhe afër 100 pengje besohet se janë në Gazë dhe të paktën një e treta e tyre besohet se kanë vdekur.

Si pasojë e ofensivës hakmarrëse izraelite, në Gazë janë vrarë më shumë se 44 000 palestinezë, shumica gra dhe fëmijë.

Gati 100 mijë punëtorë të "Volkswagen"-it iu bashkuan grevës

Berlin, 3 dhjetor - Një ditë grevë në pothuajse të gjitha fabrikat e gjigantit gjerman "Volkswagen" në Gjermani, ka përfunduar në mëngjesin e së martës, ndërsa Sindikata e Punëtorëve ka thënë se gati 100 000 punëtorë i janë bashkuar protestës.

Greva është thirrur nga Sindikata për të protestuar kundër paralajmërimeve për ulje pagash, mbyllje të disa fabrikave dhe zvogëlimin të numrit të punëtorëve në

"Volkswagen", kompanisë më të madhe në Evropë për prodhim të automjeteve.

Shefat e kompanisë, në anën tjetër, kanë përsëritur se uljet e shpenzimeve janë të domosdoshme, në mënyrë që kompania të mbetet konkurrense të treg, që të rriten fitimet, dhe ato më pas të investohen në automjetet e së ardhmes, përfshirë ato elektrike.

"Volkswagen" është përballur me rënie të kërkesës dhe rritje

të madhe të konkurrencës ndërkombëtare, sidomos prej tregjeve kineze.

Gjiganti gjerman ka pasur vështirësi në lansim dhe reklamim të modeleve elektrike të makinave.

Udhëheqës të Sindikatës së Punëtorëve kanë thënë se ky është paralajmërimi i parë kundër planeve të ashpra të menaxhmentit të kompanisë dhe që, nëse nuk merren parasysh kërkesat, protesta do të ketë sërish përgjatë dimrit.



Memli Krasniqi zgjedhet nënkryetar joekzekutiv i Kongresit të Internacionales Liberale

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, është bërë pjesë e strukturave të reja udhëheqëse të Internacionales Liberale. Ai ka njoftuar se është zgjedhur nënkryetar joekzekutiv i Kongresit të Internacionales Liberale.

Krasniqi i ka falënderuar delegatët e kongresit për besimin që ia kanë dhënë. "I falënderoj për zemërsisht delegatët e Kongresit të Internacionales Liberale, të cilët më zgjodhën nënkryetar jo-ekzekutiv të këtij organi. Është nder i madh për mua të jem pjesë e strukturave të reja udhëheqëse të

Internacionales Liberale, në kuadër të angazhimit tonë të përbashkët për promovimin e vlerave liberale dhe demokratike, ku PDK mori pjesë për herë të parë si anëtare me të drejta të plota", ka shkruar ai, duke dhënë detaje tjera. "Ky emërim i imi koincidon edhe me dy vjetorin e anëtarësimit të

Partisë Demokratike të Kosovës në grupimin politik të partive liberale-demokratike të Evropës - ALDE, para fiks dy vjetësh. Parimet themelore liberale të lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, tolerancës dhe solidaritetit, janë vlera, mbi të cilat PDK qëndron



vendosmërisht", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Bregu: Tregu i Përbashkët Rajonal është një mendësi

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, hapi një trajnim ekzekutiv katërditor për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM) për funksionarët shtetërorë nga parlamentet dhe ministritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor Gjashtë.

Në fjalën e hapjes, sekretarja e Përgjithshme e RCC-së, Bregu, theksoi rëndësinë e proceseve të ndërlidhura për përparimin e rajonit: "Plani i ri për Ballkanin Perëndimor, faza e dytë e Tregut të Përbashkët Rajonal, është vendosur këtë vit. Integrimi evropian, bashkëpunimi rajonal dhe të gjitha agjendat lokale janë procese të ndërlidhura që forcojnë



njëra-tjetrën. CRM është një mendësi dhe një proces që gjithmonë sjell gjëra të reja. Për këtë arsye, përmes këtyre katër ditëve të trajnimit intensiv, dëshirova t'i

pajisim të gjithë me aftësi për të gjetur fijen që bashkon të gjitha këto procese".

Trajnimi, i quajtur "Ndërtimi i tregut të përbashkët rajonal:

trajnim ekzekutiv për ndryshuesit e Ballkanit Perëndimor," ishte dizajnuar për t'u ofruar pjesëmarrësve njohuri dhe aftësi praktike për të mbështetur CRM dhe për t'i forcuar përpjekjet për bashkëpunim rajonal. I organizuar nga Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT) dhe Qendra Shqiptare për Politikën Evropiane (ACEP) me mbështetje nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, trajnimi ka për qëllim përgatitjen e funksionarëve shtetërorë për ta mbështetur CRM dhe për ta shfrytëzuar potencialin e tij për ta nxitur integrimin ekonomik dhe bashkëpunimin në rajon.

Tregu i Përbashkët Rajonal (CRM) është një kornizë e krijuar nga

rajoni dhe e përshtatur me rregullat dhe standardet e BE-së, e orientuar për ta përmirësuar konkurrueshmërinë, për t'i hequr barrierat dhe për ta thelluar integrimin ekonomik ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor. Duke plotësuar Planin Ekonomik dhe të Investimeve të BE-së, CRM shërben si një hap përpara drejt Tregut të Vetëm të BE-së. Zbatimi i tij bëhet përmes Planeve të Veprimit katërvjeçare të zhvilluara nga RCC në bashkëpunim me administratat e Ballkanit Perëndimor Gjashtë, partnerët rajonalë dhe Komisionin Evropian. Faza e dytë e CRM u miratua nga liderët e Ballkanit Perëndimor Gjashtë në Samitin e Procesit të Berlinit në Berlin më 14 tetor 2024.

Për një Universitet të Prishtinës që ofron mundësi të barabarta

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Në një takim të rektorit Arben Hajrullahu dhe ekipit të tij me studentë dhe të diplomuar me nevoja të veçanta, u diskutua se si Universiteti i Prishtinës të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë. Në takim me rektorin Hajrullahu dhe prorektorët morën pjesë studentët Betim Bregovina, Lum Ilazi, Marigona Hamiti dhe alumni e UP-së, ish-studentja Mimoza Musliu.

Rektori Hajrullahu tha se secili njeri është unik në këtë botë dhe di të bëjë diçka më mirë se të tjerët, ndërsa theksoi se në mandatin e tij do të angazhohet për një universitet sa më gjithëpërfshirës dhe një shoqëri të integruar e të barabartë

për të gjithë. Prorektorja Rozafa Basha që në vazhdimësi ka bërë hulumtime dhe auditime për qasjen e personave me nevoja të veçanta në objektet e Universitetit të Prishtinës dhe objekte tjera, vlerësoi se, edhe pse janë bërë përparime, mbetet ende për t'u bërë që të gjitha objektet e UP-së të jenë plotësisht të qasshme për këta persona.

Në Universitetin e Prishtinës tanimë funksionon Qendra për Studentët me Nevoja të Veçanta, me pajisje të nevojshme mësimore për personat me nevoja të veçanta.

Betim Bregovina, që ka kryer studimet master për psikologji shkollore dhe këshillim dhe në



fushën e edukimit, por edhe studimet themelore pedagogjike, tha se përmirësimet për studentët

me nevoja të veçanta duhen nisur nga gjërat e vogla që nuk kushtojnë shumë, për të mbërritur tek ato për

të cilat duhen mjete dhe resurse njerëzore.

Ndërsa Mimoza Musliu, që ka kryer studimet master për pedagogji, ngriti shqetësimin se shumë studentë me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi t'i nënshtrohen provimit të maturës dhe pastaj nuk mund të studiojnë në Universitetin e Prishtinës.

Në takim menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës u zotua se do të angazhohet konkretisht për adresimin e problemeve për të cilat u diskutua.

Organizata e Kombeve të Bashkuara 3 dhjetorin e ka shpallur Ditë Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta.

Haradinaj premtion pensione prej 500 eurosh për personat me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kandidati për kryeministër Ramush Haradinaj ka premtuar punësim dhe pensione prej 500 eurosh për personat me nevoja të veçanta. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta, Haradinaj ka thënë se ata tregojnë histori frymëzuese që na mësojnë për rëndësinë e vendosmërisë dhe durimit. "Guximi dhe përpjekjet e jashtëzakonshme të personave me nevoja të veçanta në përballjen me sfidat e

përditshme janë një dëshmi e pathyeshme e forcës së shpirtit njerëzor. Në çdo hap të tyre, në çdo arritje dhe buzëqeshje, ata tregojnë histori frymëzuese që na mësojnë për rëndësinë e vendosmërisë dhe durimit. Ëndrrat dhe aspiratat e tyre duhet të kenë të njëjtin respekt dhe mbështetje si ato të kujtudo tjetër. Kjo është një detyrë morale dhe shoqërore që nuk mund dhe nuk duhet ta neglizhojmë", ka thënë Haradinaj. Ai ka premtuar pensione prej

500 eurosh për këto kategori. "Në asnjë rrethanë nuk guxojmë ta turpërojmë vendin tonë duke mos u ofruar statusin dhe mbështetjen që meritojnë. Programi ynë parasheh masa konkrete për punësim dhe pensione të dinjitetshme prej 500 eurosh për personat me nevoja të veçanta. Kjo është garancia jonë për një qasje të drejtë dhe për mbrojtjen e dinjitetit të tyre, duke treguar se si shoqëri vlerësojmë dhe mbështesim secilin individ", është shprehur Haradinaj.





Kamberi: Serbia vazhdon t'i shkelë të drejtat e shqiptarëve në Luginë

Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka akuzuar Beogradin zyrtar për shkelje të vazhdueshme të të drejtave në Luginë të Preshevës. “Në raport me shqiptarët, Serbia është injoruese ndaj rekomandimeve të BE-së. Kur është fjala për respektimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, Serbia nuk përfillë as rekomandimet që vijnë nga Brukseli. Në Raportin e Progresit të Serbisë për vitin 2024, në kapitullin për të drejtat e pakicave, Komisioni Evropian, veç çështjes së pasivizimit, gjuhës së urrejtjes, theks të veçantë vë edhe në pozitën e nënpërfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike dhe polici”, ka thënë Kamberi

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka akuzuar Beogradin zyrtar për shkelje të vazhdueshme të të drejtave në Luginë të Preshevës, duke injoruar edhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për përmbushjen e objektivave të “Planit aksional për integrimin e shqiptarëve”. Ai ka përkujtuar se Serbia po e pengon realizimin e këtij plani, i cili është përmendur edhe në Raportin e Progresit

të Komisionit Evropian për 2024.

Në Raportin e Progresit për Serbinë, në kapitullin për të drejtat e pakicave, KE, përveç çështjes së pasivizimit, gjuhës së urrejtjes, theks të veçantë vë edhe në pozitën e nënpërfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike dhe polici. “Në raport me shqiptarët, Serbia është injoruese ndaj rekomandimeve të BE-së. Kur është fjala për respektimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, Serbia nuk përfillë as rekomandimet

që vijnë nga Brukseli. Në Raportin e Progresit të Serbisë për vitin 2024, në kapitullin për të drejtat e pakicave, Komisioni Evropian, veç çështjes së pasivizimit, gjuhës së urrejtjes, theks të veçantë vë edhe në pozitën e nënpërfaqësimit të shqiptarëve në administratën publike dhe polici. Komisioni Evropian me këtë rast kërkon veprim të menjëhershëm për përmbushjen e objektivave të ‘Planit aksional për integrimin e shqiptarëve’. Është fjala për një dokument të nënshkruar në mes të Këshillit Kombëtar

Shqiptar, në krye me Ragmi Mustafin, OSBE-së dhe Ministrinë për të Drejtat e Njeriut, të përkrahur nga delegacioni i BE-së në Serbi dhe Këshilli Evropës përmes të cilit janë definuar hapat e integritit të plotë të shqiptarëve në administratën publike e polici në periudhën 2022-2026, realizimi i të cilit, as tani, në fund të vitit 2024, nuk është filluar”, ka thënë Kamberi.

Ai ka thënë se është i vetëdijshëm për pengesat që Serbia i bën realizimit të këtij plani. Komisioni Evropian në Raportin të Progresit për 2024 ka shkruar se duhet të fillojë “zbatimi i planit të veprimit për përmirësimin e përfaqësimit të shqiptarëve në institucione duhet të përshpejtohet dhe të çojë në përmirësim të prekshe. Pakicat kombëtare mbeten të nënpërfaqësuar në administratën publike dhe policinë”. “Megjithatë kur vjen puna te ndërmarrja e veprimeve konkrete në terren,

qeveria serbe vepron në kundërshtim me këto rekomandime. Rasti i fundit ka të bëjë me Gjykatën për Kundërvajtje në Preshevë, në krye të së cilës është emëruar një gjyqtare serbe, duke injoruar gjykatësit shqiptarë. Në seancën e 28 nëntorit të këtij viti, në krye të Gjykatës për Kundërvajtje në Preshevë, komunë me mbi 95 % shqiptarë, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit në Serbi, emëroi Aleksandra Kuzmanoviq, duke marginalizuar kështu kuadrot shqiptare”, ka deklaruar Kamberi.

Ai ka shtuar se Gjykata Themelore (komunale) në Preshevë është shuar më 2011, në kuadër të reformës së gjyqësorit me moton “Drejtësia më afër qytetarit”. “Vlen të përmendet se në Preshevë, po ashtu, u. d. i drejtorit të Shtëpisë së Shëndetit para dy viteve është emëruar një mjek nga komuniteti serb që përbëjnë vetëm 3 % të popullatës së kësaj komune”, ka thënë Kamberi.

Pse flitet tash për FSK-në në veri?

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Zotimi i Kosovës për të mos e dërguar Forcën e Sigurisë në veri të vendit, pa pëlqimin paraprak të NATO-s, është i vlefshëm edhe sot, kur mandati i kësaj force ka ndryshuar, thotë për Radion Evropa e Lirë, Besfort Rrecaj, profesor i së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, deklaratat e njëanshme lëshohen nga shtetet dhe, si të tilla, konsiderohen obliguese. “Kosova duhet ta respektojë atë për aq kohë sa nuk ndryshohet nga ndonjë kryeministër ose nga ndonjë përfaqësues tjetër i shtetit të Kosovës”, thotë Rrecaj. Në vitin 2013 kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, në një letër-këmbim me shefin e atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, u zotua se FSK-ja nuk do të dislokohet në veri - zonë e banuar me shumicë serbe - pa u pajtuar paraprakisht me misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. “Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës unë jap garanci se FSK-ja do të ndërmarë mision në veri të Kosovës vetëm me pëlqimin paraprak të KFOR-it”, thuhet në letrën që mban nënshkrimin e Thaçit dhe datën 19 prill 2013. Veriu i Kosovës është shpesh vatër tensionesh, pasi popullata shumicë serbe - e dirigjuar nga Beogradi - vështirë u bindet autoriteteve

të Kosovës. Letërkëmbimi me NATO-n besohet të jetë bërë në përpjekje për ta mbajtur situatën aty nën kontroll. Por, më shumë se një dekadë më vonë, ka zëra që thonë se ky zotim si i tillë nuk është më i vlefshëm, sepse statusi i FSK-së nuk është më i njëjti. “Për NATO-n, FSK-ja nuk ka ndërnuar, por ne e kemi ndërnuar [misionin e saj përmes ndryshimeve ligjore]”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Avni Arifi, dikur shef i kabinetit të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas tij, FSK-ja nga viti 2018 e ka siguruar mandatin ushtarak, të cilin nuk e ka pasur në kohën kur është bërë letërkëmbimi me NATO-n. Pas incidentit të 29 nëntorit në Zubin Potok, ku një shpërthim i fuqishëm dëmtoi kanal kritik të Ibër-Lepencit, KFOR-i tha se institucionet e Kosovës i kanë kërkuar autorizim për dërgimin e mundshëm të FSK-së në zonën e prekur, por se misioni e ka refuzuar. “Komandanti i KFOR-it nuk e ka dhënë një autorizim të tillë bazuar në vlerësimin e tij të sigurisë dhe veprimet që tashmë janë ndërmarrë nga KFOR-i”, tha ky mision në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e Lirë. REL-i kërkoi koment për këtë çështje nga zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, por nuk mori.

Një ditë më herët, kryeministri Albin Kurti nuk konfirmoi se ka kërkuar një leje të tillë, por tha vetëm se “ushtria jonë - bazuar në marrëveshjen e vitit 2013 - nuk mund të shkojë në veri”. “Ndaj, situata atje nuk është e njëjtë si në pjesët e tjera të vendit tonë”, tha Kurti në një konferencë për gazetarë. Duke e konsideruar të dëmshme për vendin, ai e dërgoi letrën e Thaçit në prokurori në vitin 2021, por në lidhje me të nuk u mor ndonjë vendim. Po atë vit, gjatë një vizite që zhvilloi në Prishtinë, shefi i atëhershëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se pajtimi për FSK-në në veri mbetet i vlefshëm. “Kur nënshkruani një marrëveshje, ajo vazhdon [edhe] kur keni persona të rinj në pozita përgjegjëse”, tha Stoltenbergu, duke komentuar vendimin e Kurtit për ta dërguar letrën në prokurori.

“FSK-ja ka tani mandat ushtarak”

Arifi, i cili ka shërbyer në kabinetin e Haradinajt nga viti 2017 deri më 2020, thotë se Forca e Sigurisë së Kosovës përmes ligjit ka siguruar mandatin e saj ushtarak, të cilin nuk e ka pasur në vitin 2013. Kuvendi i Kosovës në vitin 2018 miratoi ndryshimet ligjore për transformimin e mandatit të

FSK-së në ushtri. Ligji për FSK-në, i cili hyri në fuqi në janar të 2019-s, thotë se kjo forcë “mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës”. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Arifi thotë se asokohe vendet partnere të Kosovës i kanë kërkuar Haradinajt që ta rinovonte marrëveshjen për mosdërgimin e FSK-s në veri. “Haradinaj u ka thënë ‘jo... konsiderojmë që [FSK-ja] duhet të ketë mandat të plotë dhe se Ministra e Mbrojtjes duhet të jetë operative në të gjithë Kosovën’. Haradinaj ka refuzuar, mirëpo ka thënë se koordinimi me NATO-n është esencial dhe nuk ndodh kurrë asgjë pa koordinim me NATO-n”, thotë Arifi. Sipas tij, nëse kryeministri Kurti kërkon bazë ligjore për ta dërguar FSK-në veri, ai atë e ka - nisur nga pikëpamja e institucioneve të Kosovës. Ndërsa nga pikëpamja e NATO-s, thotë ai, misioni i FSK-së nuk ka ndryshuar dhe mbetet ai i vitit 2008, kur ajo kishte mision “t’i ndihmonte autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera”.

“Letra ka karakter obligues”

Profesori Rrecaj nuk pajtohet.

Ai thotë se letra e Thaçit ka karakter juridik obligues për Kosovën. Sipas tij, ajo është një deklaratë e njëanshme, por rezultat i diskutimeve të përfaqësuesve institucionalë të Kosovës me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare. Për më tepër, shton Rrecaj, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së është ende në fuqi dhe, bazuar në të, interpretimi final i situatës së sigurisë në Kosovë i takon KFOR-it. “Sipas Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha shtetet janë të obliguara t’i respektojnë rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe vendimet e tij. Rrjedhimisht, kjo vlen edhe për Kosovën”, thotë Rrecaj. KFOR-i u miratua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së pas përfundimit të luftës më 1999. Rezoluta 1244 e tij i autorizoi shtetet anëtare të OKB-së për të mbajtur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, e cila sot ka mbi 4 400 trupa. KFOR-i është përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare është Policia e Kosovës. Për dallim prej FSK-së, shkuarja e Policisë së Kosovës në komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, nuk është e kufizuar.



PREKAZI, VARRAGA DHE UKRAINA!



Behxhet
Sh. Shala - BAJGORA

1. PREKAZI: Për çdo shqiptar lirisht, Prekazi është kryeqyteti i çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Është kuptimi i vet qenies dhe ekzistencës shqiptare. Është akti më i lartë njerëzor, moral dhe kombëtar. Prekazi është Kushtetuta e të gjitha kushtetutave që sanksionojnë të drejtën për liri, çlirim dhe pavarësi. Është orakulli i të gjitha nullozave, tregimeve, gjakimeve për trimërinë, sakrificën, vetëmohimin, rënien, ngritjen, ringritjen dhe ringjalljen e idesë dhe njeriut. Prekazi është vendlindja dhe vendkalimi në amshim i Komandantit Legjendar Adem Jashari, i frymëzuar nga Komandanti Politik, Bacë Adem Demaçi. Prekazi është parajsja e lirisë dhe ferri i robërisë. Në çdo 28 nëntor, lumenj patriotësh që kontribuuan për këtë liri, gjeneratat që po rriten në këtë liri dhe filizat që ende nuk e kuptojnë lirinë, derdhen drejt Prekazit pavarësisht kohës dhe rrethanave të tjera. Prekazi shndërrohet në kryeqytet të gjeografisë shqiptare, në një Piemont shqiptar. Luftëtarë krenarë, në moshë, pa gjymtyrë, në karroca, bebe, pleq, me uniforma të UÇK-së, me plisa dhe flamuj kombëtarë, e kalojnë itinerarin e lavdisë për

të cilën ndjejnë krenari sikur të ishin edhe vet pjesë e luftës. Prekazi është djep i të gjithë shqiptarëve dhe mbarë njerëzimit që e duan lirinë! Më herët shkoja në Prekaz pikërisht me 28 nëntor dhe ndjehesha si të isha në zgjua të bletës. Pastaj shkoja ditëve jashtë kësaj dite. Në 28 nëntorin e këtij viti nuk kisha vendosur të shkoj në Prekaz, por këmbëngulja e një shoku me të cilin shoqërohem më shumë se 50 vjet, Hajrullah Ukës nga Perani i Podujevës, e që më tepër se 30 vjet jeton në Gjermani, nuk më la asnjë mundësi ta refuzoja. Hajrullah Uka nuk njeht tjetër festë përveç 28 nëntorit, nuk njeht tjetër flamur përveç atij kombëtar, nuk njeht tjetër ushtri përveç UÇK-së, nuk njeht tjetër komandant ushtarak përveç Adem Jasharit dhe nuk njeht tjetër frymëzim kombëtar përveç Bacë Adem Demaçit. Kur u lirua nga Burgu i Hagës Ramush Haradinaj, Hajrullah Uka erdhi nga Gjermania për të festuar lirinë e tij dhe vallëzoi, bashkë me qytetarë të tjerë në qendër të Prishtinës. Jam i sigurt se kur të lirohen Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe luftëtarët e tjerë të lirisë që po mbahen pengje në Hagë, Hajrullah Uka do t'ia mësyjë këmbë për në Kosovë, për Festën e Madhe. E si ta refuzoja kërkesën e një patrioti që kishte dëshirë të shkojë në Prekaz vetëm me mua! Shkuam në Prekaz, ku takuam dhe bashkëbiseduam me ata që kaluan në amshim, me patriotë të vërtetë, por edhe me horra, kryesisht të

politikës, që mendojnë se duke vizituar Prekazin, këtë vend të shenjtë, mund ta përdorin për larje të mëkateve dhe shërim të ndërgjegjes së vuarë. Në këtë ditë dhe datë, edhe të pafytyrët veshin fytyra kombëtare si alkimi ditore.

2. VARRAGA: Gjatë diskutimeve për të kaluarën dhe të tashmen, nga e cila varej edhe e ardhmja, në dalje të Mitrovicës e huqëm rrugën; në vend se për Skenderaj, shkuam për Zubin Potok duke e kaluar këtë. E pashë një mbishkrim të fshatit Varragë që për mua nuk thoshte asgjë përveç një emërtimi identifikues.

Rruga prej daljes së Mitrovicës e thuajse deri në kufi me Serbinë ishte e qetë, jo shumë e ngarkuar; policët nuk dukeshin, por zgjonte interesimin e banorëve çdo veturë e panjohur dhe çdo person i panjohur. Kur pyetëm për rrugën dy serbë lokalë, një i moshuar dhe një i ri, i riu nuk e lejoi të moshuarin të flasë, por foli vetë duke na treguar rrugën. Askush nuk do të mendonte që një fshat si Varraga, pas vetëm një dite të plotë, do të bëhej i njohur dhe i përmendur nga të gjitha qendrat vendimmarrëse në botë. Pas shpërthimit terrorist dhe dëmtimit të kanalit të Ibër-Lepencit, Varraga u bë epiqendër e interesimit, sepse po rrezikohej siguria e Kosovës, rajonit dhe ajo globale. Pas një dite jo të plotë, fshati Varragë, në dukje të jashtme i qetë, u mbush me policë për ta hetuar rastin dhe për ta ruajtur sigurinë, si dhe me shërbime emergjente për të

eliminuar dëmet nga ky shpërthim terrorist. Nëse merren pamjet e kamerave, sigurisht se aty do të dukemi Hajrullahu dhe unë, jo se vdisnim ta vizitonim Varragën, por sepse e humbëm rrugën.

3. UKRAINA: Ka hyrë në fundviti të tretë në luftë me Rusinë, në mbrojtje të shtetit dhe qytetarëve të saj. Është një luftë e pabarabartë, dhe vetëm përkrahja e botës demokratike po e mban Ukrainën në këmbë, pa u rrëzuar dhe pa u dorëzuar. Përkrahje të jashtëzakonshme i dha edhe Kosova, në planin politik dhe ekonomik, përmes KM Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani, bashkë me Donika Gërvallën-Schwarz, mendermethënë zëvendëskryeministër dhe ministër për Punë të Jashtme dhe Diasporë. Besnik Gjylekari i dha goditje të papërballueshme Rusisë, duke zbatuar të gjitha sanksionet, si asnjë vend tjetër në botë. Matrapazë dhe manipulues. Por, cila është ndërlidhja midis Ukrainës dhe Varragës? Fillimisht, një zëvendëskryeministër i Drejtësisë, me një kapacitet profesional të një referenti juridik me sukses të mjaftueshëm, deklaroi se metoda e përdorur në Varragë ishte më parë përdorur nga rusët në Ukrainë. Këtë budallaki logjike dhe materiale, KM Kurti e përdori në konferencë për media, duke menduar se të gjithë në botë vetëm këto fjalë i kanë prituri! Por kujt i intereson në botë se çfarë thonë Zoti dhe Rrogëtari? Jam i sigurt se vlerësuesit e sigurisë e kanë të

ditur se ajo pjesë e Kosovës është e mbuluar dhe mbikëqyret nga dronët e shumtë dhe satelitët. Me një bashkëpunim dhe vullnet për ta zbuluar të vërtetën, kjo edhe do të ndodhë, përveç nëse interesat politike pengojnë zbardhjen e saj. Një urti popullore thotë: "Kush ngutet, përmutet". U ngutëm për rastin e Banjskës dhe fituam sanksionet. Nëse e përsërisim ngutjen me rastin e Varragës, çfarë do të fitojmë? Të trashët e Surlës. KM i Kosovës, Albin Kurti, nuk duhet të sillet me opinionin sikur çdo ditë të ishte 1 Prilli, Dita e Rrenave. Çdo herë që përplaslet me Hashim Thaçin, vetëm se digjet. Hashim Thaçi është pjesë e historisë më të re të Kosovës, në kohën kur Kurti mungonte. Historia mund të rishkruhet përmes manipulimit të çastit, por historia e pushtetit aktual (lexo: Albinit) është si një doner i papjekur mirë—hahet shpejt dhe po aq shpejt del nga zorrët. Kemi prekur fundin e pusit politik, moral, dhe kombëtar, kur antikombëtarët, disa ministra të Kurtit, shesin moral kombëtar duke sulmuar vlerat e vërteta kombëtare. Merreni me mend, Agim Tartufi-Peçurka sulmon Ramush Haradinajn për tradhti duke i thënë, në stilin e George W. Bushit, "Enough is enough!" Agim Vaganica, i paekuilibruar dhe injorant ekzemplar. Dhe këta pastaj shkojnë në Prekaz. Varret morale dhe njerëzore vizitojnë Varret e Shenjta; të pandershmit shkelin në tokën e ndershmerisë. "Enough is enough" apo "Mjaft është mjaft" për horra të kësaj rase!

Vdiq gazetari Zijadin Gashi

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Gazetari Zijadin Gashi ka vdekur të martën në moshën 51-vjeçare. Ai është përballur në muajt e fundit të jetës me tumor në tru. Gashi e ka ushtruar profesionin e gazetarit që prej vitit 1997, duke mbuluar aktualitetin politik në Kosovë. Më herët gjatë vitit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës i ka dhënë mirënjohje për kontributin e dhënë në gazetari, para dhe gjatë luftës në Kosovë, në periudhën 1998-'99. Nga viti 2001 e deri më 2020 ka punuar për Radion Evropa e Lirë gazetar dhe një periudhë shef i byrosë në Prishtinë, për të vazhduar më pas kontributin në media të tjera në Kosovë. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka ngushëlluar

familjen dhe komunitetin e gazetarëve për vdekjen e Gashit, duke e përshkruar si gazetar të përkushtuar, i cili tërë jetën ia kushtoi punës në medie. "Karriera e gjatë dhe kontributi i tij në medianë e shkruar, elektronike dhe televizive u karakterizuan nga integriteti dhe angazhimi i palëkundur për informim të publikut, saktë dhe në mënyrë profesionale", është thënë në deklaratën e lëshuar nga Presidenca. Zijadin Gashi e ka përfunduar shkollimin e mesëm në gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë për t'i vazhduar studimet në Universitetin e Prishtinës. Ai ka lënë mbrapa vetes gruan dhe tre fëmijë, dhe një trashëgimi të vlefshme në gazetari.



Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit për sulmin në Zubin Potok

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar një muaj paraburgim për Jovan Viqentijeviq, i dyshuar për sulmin në kanal e Ibër-Lepencit në Varagë të Zubin Potokut. Lajmin e ka konfirmuar për Telegrafin, zëdhënësja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi.

Një shpërthim i fuqishëm të premten në mbrëmje në Varagë

të Zubin Potokut ka dëmtuar kanal e ujit Ibër-Lepenc. Kryeministri i vendit, Albin Kurti, këtë sulm në veri të Kosovës e ka quajtur kriminal dhe terrorist dhe vjen nga bandat e orkestruara nga Serbia. Sulmin e ka dënuar edhe bashkësia ndërkombëtare dhe ka kërkuar sjelljen e autorëve përgjegjës para drejtësisë. E Prokuroria Speciale një ditë

më parë ka bërë me dije se në koordinim me Policinë e Kosovës kanë kryer disa kontrole në disa lokacione të ndryshme, ku janë gjetur dhe sekuestruar armë të ndryshme dhe pajisje të tjera. Lidhur me sulmin terrorist janë shoqëruar në stacionin policor 10 persona. Policia dhe organet e drejtësisë po vazhdojnë veprimet hetimore për këtë rast.



Akuzat ndaj sistemit të drejtësisë, Këshilli Prokurorial i reagon kryeministrit Kurti

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) kanë reaguar ndaj kryeministrit të vendit, Albin Kurti, i cili ditën e hënë ka bërë disa kritika drejtuar sistemit të drejtësisë.

Kurti në fjalimin e tij para deputetëve ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk mund ta bëjë edhe prokurorinë dhe gjyqësinë, dhe se Prokuroria ende nuk ka zbardhur rastin e Astrit Deharit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) në reagimin e tyre thonë se detyrohen që edhe një herë të reagojnë ndaj deklaratave të zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës,

konkretisht ndaj deklaratës së kryeministrit të vendit, Albin Kurti, i cili dje nga foltorja e Kuvendit ka hedhur akuza të padrejta në drejtim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj. "Deklaratat e kryeministrit për raste individuale, duke i interpretuar ato në mënyrën e tij dëshirore, pa i ditur faktet dhe duke e keqinformuar publikun në mënyrë të qëllimshme, lëndojnë ndjenjat e familjarëve të të ndjerëve, përbëjnë ndërhyrje dhe presion të drejtpërdrejtë në punën e Prokurorisë dhe cenojnë rëndë pavarësinë e sistemit të drejtësisë", thuhet në reagimin e tyre. Më tutje, theksohet se "një qasje



e tillë e kryeministrit të Republikës së Kosovës dëmton funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka për qëllim minimin e reputacionit të Prokurorit të Shtetit në përpjekjet institucionale për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe në vend që kryeministri t'i mbështesë kërkesat buxhetore të sistemit

prokurorial, ai zgjedh rrugën e sulmeve ndaj institucioneve të Prokurorit të Shtetit". "Andaj, KPK dhe ZKPSH i bëjnë thirrje kryeministrit të vendit, anëtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar dhe deputetëve të partisë në pushtet, që të jenë të përmbytur, të tregojnë sjellje të përgjegjshme institucionale dhe të mos tentojnë që përmes diskursit dhe

retorikës politike ta sulmojnë sistemin prokurorial", vijon reagimi i tyre.

Kurti të hënë ka adresuar akuza ndaj sistemit të drejtësisë, veçmas kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj. "Qeveria e Kosovës nuk mund ta bëjë edhe prokurorinë dhe gjyqësinë. Prokuroria duhet të zbardhë rastin e shokut tonë, të mbytur në burgun e Prizrenit më 5 nëntor 2016, Astrit Dehari. Prokuroria nuk është reformuar. Në vitin e ardhshëm i bëjmë 4 vjet qeverisje, por KPK-ja është e njëjta. Aty në krye edhe më tutje me ndikim dhe funksion është Blerim Isufaj, i cili vrasjen e Dino Asanajt e shndërroi në vetëvrasje dhe vetëvrasjen e Ismet Sopës e shndërroi në vrasje. Ky është problemi, të nderuar deputetë", u shpreh Kurti.

SBASHK-u nuk e përjashton grevën nëse nuk i plotësohen kërkesat

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) do të mbajë të mërkurën protestë para Ministrisë së Arsimit dhe Qeverisë.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, në një konferencë për medie, tha se nëse qeveria dhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, nuk reflektojnë mbi kërkesat e tyre, do të hyjnë në grevë të përgjithshme. Ai ka dhënë hollësi rreth kësaj proteste. "Qasja e tyre dhe injorimi i tyre i vazhdueshëm sollin vendimin për veprime



sindikale. Fillimisht u vendos që më 4 dhjetor të bëhet protestë dhe presim që në protestën para MASHII-t dhe qeverisë të jenë mbi 1500 pjesëmarrës. Nëse

qeveria, sidomos ministrja Nagavci nuk reflektojnë, do ta analizojmë situatën dhe do të marrim vendime, pa përjashtuar grevën e përgjithshme", tha

Jasharaj. Jasharaj e ka akuzuar Kurtin dhe ministrat e tij se e kanë paralizuar dialogun e mirëfilltë me sindikatat. "Kurti dhe ministrat e tij premtuan shumë, deklaruan se do ta respektojnë zërin sindikal dhe fuqizimin e sindikatave, por kanë bërë të kundërtën. Gjatë këtyre viteve paralizuan dialogun e mirëfilltë, duke mos e nënshkruar Marrëveshjen Kolektive, duke ua mohuar të punësuarve në sektorin publik dhe privat mundësinë për t'i ruajtur të drejtat në punë dhe për të arritur disa benefite si të

gjithë kolegët e tyre kudo në vendet e Ballkanit e të Evropës", ka thënë Jasharaj.

Kreu i SBASHK-ut tha se ministri Murati do të kujtohet si njeriu që deshi t'ua ndalë bukën e gojës pse kërkuan mundësinë për një kafshatë bukë më shumë. "Në betejën e vazhdueshme të qeverisë me SBASHK-un mori pjesë aktive edhe ministrja Nagavci. Ajo u mbush me inat pse SBASHK-u është kaq unik, prandaj u angazhua për ta dobësuar SBASHK-un, por kurrë nuk ia arriti", tha ai.

Shërbime mjekësore dhe psikologjike për policët, vazhdohet marrëveshja e bashkëpunimit me ShSKUK-në

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Policia e Kosovës dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) kanë nënshkruar vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike për personelin policor dhe kadetët policorë.

Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha dhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi. "Qëllim i takimit ishte vazhdimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të ShSKUK-së dhe PK-së për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike për personelin policor dhe rekrutët (kadetët policorë). Ky

memorandum u nënshkrua sot më 3.12.2024 nga drejtori i përgjithshëm i PK-së kolonel, Gazmend Hoxha dhe nga drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi. Memorandumi i bashkëpunimit deri në këtë fazë të zbatimit ka rezultuar shumë i suksesshëm me kontrollimet mjekësore /psikologjike për rekrutët e rinj të PK-së dhe kontrollimi sistematik i punonjësve të PK-

së, të cilat janë realizuar në QKUK për rekrutët dhe punonjësit e PK-së nga rajoni i Prishtinës si dhe të atyre nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të PK-së në spitalet e përgjithshme të ShSKUK-së. Zyrtarët policorë janë në shërbim dhe të gatshëm për përmbyshjen e detyrave të tyre policore në çdo kohë, andaj përkrahja në trajtimin e tyre mjekësor me prioritet shkon në



mbështetje të misionit të tyre në shërbim të qytetarëve të RKS-së pa dallim", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipërfaqja e punuar e tokës dhe e BPV-së janë rritur për 50 për qind

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në festën tradicionale Darka e Lamës, e cila u organizua nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ditë kjo që shënon përfundimin e të korrave për ta festuar vitin e bereqetshëm.

Në këtë ditë të veçantë, në darkën e shtruar me prodhime vendore, kryeministri Kurti

falënderoi veçanërisht fermerët për punën e palodhshme të tyre në rritjen e prodhimit vendor. Me këtë rast, ai konfirmoi mbështetjen dhe angazhimin e qeverisë për ta, duke theksuar se sukseset i gëzojmë së bashku, dhe gjithmonë jemi me shpresën që kjo begati të na përcjellë edhe vitin tjetër. "Sivjet kemi një korelacion interesant krahasuar me para katër

viteve: edhe sipërfaqja e punuar e tokës edhe Bruto Produkti Vendor janë rritur për 50 për qind. E punojmë tokën më shumë dhe e rrisim ekonominë tonë më lart. Për tokat e mbjella, grurin e korrur, bukën e sofrës, mikpritjen dhe bujarinë që na karakterizon si komb e si shtet. Gëzuar e ta shijoni këtë darkë të shtruar vetëm me produkte vendore", u shpreh kryeministri Kurti.



Hoxhaj viziton fabrikën ku punojnë personat me nevoja të veçanta, flet për mirëqenien dhe barazinë



PRISHTINË, 3 DHJETOR - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës dhe deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, vizitoi të martën fabrikën "Freesia" në Lipjan, në të cilën janë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Fondacioni "Golden Eagle".

Gjatë vizitës Hoxhaj mbajti një fjalë rasti, ku theksoi rëndësinë e promovimit të të drejtave, mirëqenies dhe barazisë për personat me aftësi të kufizuara. Ai vlerësoi fabrikën "Freesia" si një shembull frymëzues të integritimit të këtyre personave

në tregun e punës dhe në shoqëri. "Qëllimi i kësaj dite është promovimi i të drejtave, mirëqenies si dhe rritja e ndërgjegjësimit lidhur me situatën e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e shoqërisë dhe aspektet e zhvillimit - jetës politike, sociale, ekonomike dhe kulturore", tha Hoxhaj.

Në këtë ngjarje u paraqitën punime artistike të krijuara nga persona me aftësi të kufizuara dhe u dhanë çmime për artistët pjesëmarrës. Gjithashtu, Fondacioni "Golden Eagle" ofroi mbështetje për organizatat që

promovojnë barazinë dhe fuqizimin e kësaj kategorie. "Pata nderin të mbaj një fjalë rasti dhe të theksoj rëndësinë e përkrahjes së vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara. Shembulli i fabrikës 'Freesia' është një model që duhet ndjekur për të krijuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse", u shpreh Hoxhaj.

Kjo vizitë dhe angazhimi i Hoxhajit janë një dëshmi e rëndësisë së përkushtimit institucional dhe shoqëror për avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Shtyhet afati për subvencionim të konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme



PRISHTINË, 3 DHJETOR - Shtyhet afati i aplikimit për fazën e dytë për subvencionim të konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme - sistemi fotovoltai (fv) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum, ka njoftuar Ministria e Ekonomisë. "Është shtyrë afati për aplikim për fazën e dytë të dy thirrjeve publike për subvencionimin e sistemit fotovoltai për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum për konsumatorët

familjarë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMVM), që realizohet me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian në Kosovë. Afati për aplikim për dy thirrjet vazhdohet deri më 30 dhjetor 2024 për fazën e 2-të", ka njoftuar kjo ministri.

Në thirrjen për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e sistemeve të energjisë së ripërtëritshme - Sistemi fotovoltai (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum, subvencionimi do të jetë 250 euro/kWp, deri në 1,750.00 euro. Në thirrjen për mbështetjen e

NMVM-ve në investimin e sistemeve të energjisë së ripërtëritshme - Sistemi fotovoltai (FV) për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum, vlera e subvencionit për kapacitetet instaluese 3-9 kWp, do të jetë 250 euro /kWp, deri në 2 000.00 euro. Për kapacitetet instaluese 10 kWp ose më shumë do të jetë 200 euro /kWp deri në 6 000.00 euro.

Për bizneset në pronësi apo bashkëpronësi të grave nga pesëdhjetë e një për qind (51 %) do të subvencionohen 200 euro shtesë.

Administrata Tatimore: 883.6 milionë euro tatime të mbledhura për 11 muaj

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë me dije se nga janari 2024 deri më 30 nëntor 2024 janë mbledhur 883.6 milionë euro tatime.

Në njoftimin për medie thuhet se kjo vlerë e të hyrave shtetit i garanton stabilitet financiar dhe ekonomik. "Të hyrat e inkasuara për këtë periudhë janë hiç më pak se 90.7 milionë euro apo 11.4% më shumë se e

njëjta periudhë e vitit të kaluar. Se ka performancë të jashtëzakonshme, këtë së fund e ka vlerësuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar-FMN, sipas të cilëve ATK-ja në 7 nga 8 indikatorët është më lartë se vendet në zhvillim, si dhe në 5 nga 8 indikatorët është mbi mesataren e vendeve të zhvilluara. Sipas FMN-së, ATK-ja ka bërë përparim të dukshëm në krijimin e një

sistemi tatimor funksional, në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe në forcimin e planifikimit strategjik, menaxhimin e rrezikut të përmbushjes dhe funksionet themelore të Administratës Tatimore. Mbledhja e të hyrave si në vlerë e po ashtu edhe si përqindje të BPV-së, tregon një trend të vazhdueshëm të rritjes", thuhet në njoftim.



Makthi 2000-vjeçar i politologëve: Mobokracia, ose sundimi nga turmat

Liberalët bëhen “dembelë” kur mendojnë mbi turmat. Ata kanë brohoritur për “fuqinë e popullit” kur ajo kërcënon regjimet që ata nuk i aprovojnë, si për shembull në Lindjen e Mesme, ndërsa nga ana tjetër bëjnë një sy qorr ndaj teprimeve nga protestuesit që ata mendojnë se janë në anën e djathtë të historisë.

Në gushtin e vitit 2020, një botues i çështjeve publike botoi librin “Një mbrojtje të plaçkitjes: Një histori e trazuar e veprimtari jo civil” nga Viki Osterveil. Pushtimi i Kapitolit nga turma e mbështetësve të presidentit Donald Trump më 6 janar, ishte një kujtesë e rreziqeve që vijnë nga luajtja me zjarrin.

Është naivë të supozohet se turmat do të kufizohen vetëm në anën “e bukur” të spektrit politik; nga natyra e tij lloji i turmave të krahut të majtë, gjeneron llojin e turmave në të djathtë. Dhe është dyfish naivë të presësh që turmat do t'i vendosin kufij vetes; dalja jashtë kontrollit është në natyrën e tyre.

Filozofët politikë e kanë thënë këtë gjë vazhdimisht për më shumë se 2.000 vjet. Teoricienët politikë para-modernë, nuk u lodhën asnjëherë të paralajmëronin se sa herë që do të përfitojë nga rasti “përbindëshi me shumë kokë” do të shkelë rendin në fuqi.

Edhe mendimtarët liberalë shqetësoheshin se demokracia mund të krijonte “mobokraci” (sundim të turmave). Ata argumentuan se vullneti i njerëzve duhej të frenohej nga një kombinim i ligjeve të Kushtetutës (të drejtat individuale, bashkë me kontrollin dhe ekuilibrat) dhe i kulturës qytetare. Më i mençuri midis tyre shtoi se prishja e kufizimeve të tilla mund t'a shndërrojë demokracinë në sundimin e turmës.

Vepra e parë e madhe e filozofisë politike, “Republika” e Platonit, ishte, pjesërisht, një meditim mbi të këqijën që vijnë nga sundimi i turmës. Platoni e konsideronte demokracinë si më shumë sesa sundimi i turmës me një emër tjetër, ndoshta jo të dhunshme, të paktën në fillim, por me të njëjtën mungesë të kontrollit të impulsit.

Ai krahasoi qytetarët e demokracive me blerësit që shohin në treg një “pallto me shumë ngjyra” dhe e blejnë atë vetëm për të zbuluar se shqepet kur është veshur vetëm 2 herë. Ai vuri në dukje se demokracitë janë të vështira për t'u provuar kufijtë.

Gjithshtu, Platoni argumentoi se demokracitë degradojnë në mënyrë të pashmangshme në anarki, pasi të varfrit plaçkitnin



të pasurit, dhe kaosi prodhon kolaps. Anarkia çon në sundimin e tiranëve: një lider autoritar, mund t'u drejtohet instikteve më të këqija të turmës, pasi ai vetë drejtohet nga instiktet e tij më të këqija.

Ai është në një farë mënyre turma në formën e një personi të vetëm. Për Platonin, e vetmja alternativë e zbatueshme për sundimin e turmës, ishte sundimi i një kaste gardianësh: mbretër-filozofë, të stërvitur që në foshnjëri për të kontrolluar emocionet e tyre, dhe për t'a vendosur mençurinë përpara instiktet.

Aristoteli, nxënësi i madh i Platonit, bëri dallimin midis tre formave të ligjshme të qeverisjes: mbretërimin, aristokracisë dhe demokracisë. Ai argumentoi se secila prej tyre ka hijet e saj të errëta: tiraninë, oligarkinë, dhe sundimin e turmës.

Pastaj ai përshkroi mënyrat në të cilat këto forma të vërtetshme të qeverisjes evoluojnë në të kundërtat e tyre: demokracia bëhet sundim i turmës, ku të pasurit rrëmbejnë pasurinë e shoqërisë. Duke qenë një mendimtar më praktik se Platoni, Aristoteli, argumentoi se kishte dy mënyra për të parandaluar degradimin e demokracisë në një mobokraci: përzjerja e saj me elemente të mbretërisë dhe aristokracisë për të frenuar vullnetin e njerëzve; dhe krijimi i

një klase të madhe të mesme, që ka interes stabilitetin e vendit. Shekujt vijues sollën disa risi në të menduarit mbi turmën. Makiaveli spekuloi se princat e zgjuar mund të ishin në gjendje të përfitonin nga kaosi, nëse ata mund t'a përdornin turmën kundër një regjimi në shpërbërje e sipër. Ndërkohë, elitat kënaqeshin me demonizimin e saj.

Ata shpikën një mori emrash të frikshëm për popullin – “kafshë me shumë kokë”, “turmë e vrazhdë”, “vulgu i lëvizshëm”, ose një turmë e ndryshueshme, e cila dha shkas për termin anglisht mob “turmë”. Ata gjithashtu shpikën mënyra cinike për të devijuar energjitë e saj anarkike, veçanërisht “bukën dhe cirkun” në kohën e Perandorisë Romake. Por qasja ndryshoi me revolucionet franceze dhe amerikane, të cilët bazoheshin në qasje të kundërta për sundimin e turmës. Në fillim shumë njerëz e lavdëruan “fuqinë e popullit” gjatë revolucionit francez. Por, po shumë prej tyre ndryshuan mendje, kur zbuluan se larg nga çlirim të mirësisë natyrore të njeriut, revolucioni kishte liruar demonët e tij të brendshëm.

Pra, Revolucionin Francez prodhoi një kritikë të fuqishme konservatore ndaj sundimit të turmës. Në librin e tij “Reflektime mbi Revolucionin në Francë”, Edmund Burke, thotë se turma ka një psikologji

kolektive që e bën të rrezikshme në një mënyrë unike.

Ai parashikoi shumë saktë se revolucioni do të përfundonte me masakrimin e mijëra njerëzve (përfshirë mbretin, mbretëreshën dhe priftërinjtë), dhe ngjitet në pushtet të një diktatori që mund të rivendoste rendin dhe ligjin.

Revolucioni Amerikan pati sukses atje ku dështoi Revolucionin Francez dhe pasardhësit e tij, pasi u bazua në frikën ndaj “kaosit dhe neverisë dhe padurimit të turmës”. Etërit Themelues të SHBA-së, argumentuan se demokracia mund të shmangte shndërrimin në mobokraci vetëm nëse ajo ishte e mbrojtur nga një seri kufizimesh që kontrollojnë fuqinë e njerëzve.

Ajo u nda midis degëve të qeverisë, në një mënyrë të tillë që askush të mos përdorte më shumë sesa duhej. Qytetarëve iu dhanë të drejta të gjëra kushtetuese. Senatorëve mandate 6-vjeçare për të mos qenë të ndërvarur nga zgjedhjet presidenciale. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë u emëruan për gjithë jetën, për t'u siguruar që ata të mos shkarkohen nga njerëzit e degëve të tjera të pushtetit.


Lufta e Dytë Botërore dhe disfata e nazizmit, sollën një epokë të vetëbesimit demokratik, ndërsa rënia e Murit të Berlinit në një eufori demokratike. Por disa pesimistë vazhduan të

paralajmëronin se demokracitë mund të degjeronin në sundimin e turmës, nëse ata neglizhonin shëndetin e institucioneve të tyre politike dhe kulturën qytetare.

Dhe vitet e fundit, pesimistët janë shtuar. Përvoja e vendeve të tilla si Egjipti gjatë Pranverës Arabe, konfirmoi paralajmërimet se pa institucione të forta, demokracia do t'i nënshtrohej sundimit të turmës. Zgjedhja e Donald Trump, një yll i Reality TV, ngriti pyetje të mëdha rreth shëndetit të regjimit politik të Amerikës.

Por epoka e naivitetit demokratik vdiq më 6 janar. Tani ka ardhur koha për një epokë të sofistikimit demokratik. Demokracitë mund të jenë mbrojtja më e mirë kundër sundimit të turmës, por ato mund të jenë të suksesshme vetëm nëse vendet bëjnë përpjekjet e nevojshme për të ushqyer institucionet demokratike: duke u mbrojtur nga pabarazia e tepruar, duke siguruar që votuesit të kenë qasje në informacione objektive, në reduktimin e fluksit të parave në politikë, si dhe në forcimin e kontrolleve dhe ekuilibrave.

Përndryshe, sundimi i popullit do të bëhet vërtet sundimi i turmës, dhe rendi i qëndrueshëm demokratik që lulëzoi nga Lufta e Dytë Botërore e tutje, do të duket vetëm si një kuriozitet i shkurtër historik. / Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Liga Unike fillon sot me ndeshjen Tirana - Vllaznia

Tiranë, 3 dhjetor - Sot (e mërkurë) fillon zyrtarisht sezoni 2024/25 në Ligën Unike të basketbollit në konkurrencën e meshkujve. Megjithatë, sezoni i ri nis me ndeshjet e xhiros së dytë, në të cilën do të përballen skuadrat nga Shqipëria. Dueli i parë do

të jetë ai ndërmjet Tiranës dhe Vllaznisë së Shkodrës, i cili luhet të mërkurën prej orës 18:00 në kryeqytetin e Shqipërisë. E përballja e dytë, ajo ndërmjet Besëlidhjes dhe Teutës së Durrësit, do të zhvillohet të enjten, po ashtu prej orës 18:00. Ndeshjet e

skuadrave nga Kosova të kësaj xhiroje, Bashkimi – Vëllaznimi dhe Golden Eagle Ylli – Sigal Prishtina, nuk do të luhen për shkak se do të llogariten rezultatet e arritura në Superligën e Kosovës. Ky sezon i Ligës Unike te meshkujt do të jetë i veçantë, pasi tetë

skuadrat pjesëmarrëse, katër nga Kosova dhe Shqipëria, janë të ndara në dy grupe. Grupi A përbëhet nga Besëlidhja, Teuta, Bashkimi e Vëllaznimi, kurse pjesë e Grupit B janë Golden Eagle Ylli, Sigal Prishtina, Tirana dhe Vllaznia. Ndeshjet do të luhen me



sistem vajtje-ardhje dhe dy ekipet e renditura në pozitën 1 dhe 2 të secilit grup do të kualifikohen në "Final Four" që do të mbahet vitin tjetër në Kosovë.

Sot zhvillohen dy ndeshje në Kupën e Basketbollit



Pejë, 3 dhjetor - Nga kjo mesjavë fillojnë ndeshjet e Kupës së Kosovës në Basketboll te meshkujt. Shorti ishte hedhur pas shtatë xhirove të zhvilluara sipas sistemit të Bergerit. Përballja kryesore do të zhvillohet ndërmjet rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës.

Takimet ndërmjet këtyre dy skuadrave gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritjet edhe të mërkurën mbërma. Po ashtu, të mërkurën zhvillohet sfida ndërmjet Vëllaznimit dhe Golden Eagle Yllit. Të enjten do të përballen Proton Cable Prizreni me Trepçën, si dhe

Bora me Bashkimin. Javën e ardhshme do të zhvillohen ndeshjet e kthimit, ku do të përcaktohet se kush do të kalojë në gjysmëfinale. Në këtë edicion të kësaj gare edhe gjysmëfinalët zhvillohen me sistem vajtje-ardhje, ndërsa finalja zhvillohet në shkurt të vitit të ardhshëm.

KUPA E KOSOVËS (ÇERKFINALET)

Të mërkurën takohen:

19:00 Peja - Sigal Prishtina

19:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli

Të enjten takohen:

19:00 Proton Cable Prizreni - Trepça

19:00 Bora - Bashkimi

Rumania nuk pajtohet me vendimet e UEFA-s, ankohet në CAS

Bukuresht, 3 dhjetor - Federata e Futbollit e Rumanisë ka njoftuar se do t'i sfidojë vendimet e UEFA-s duke u ankuar në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS) për ato që ndodhën në fund të ndeshjes me Kosovën. Edhe pse e mori fitoren në tavolinë ndaj Kosovës, Federata Rumune s'u kënaq me kaq, pasi konsideron se mori gjoba të shumta e të panevojshme për ndeshjen që nuk përfundoi në fushën e blertë. "Dardanët" e lanë fushën pas thirrjeve raciste të tifozëve rumunë derisa rezultati ishte 0-0 në minutat

shtesë, shkruan mediumi rumun "gsp.ro". UEFA ia dha Rumanisë fitoren me rezultat zyrtar, 3-0, ndërsa Federata e Rumanisë u gjobit në total 128 mijë euro. Ndër të tjera, shtëpia e futbollit evropian i detyroi "Trekolorët" që ta zhvillojnë një ndeshje pa praninë e shikuesve. Ky dënim do të aplikohet në Ligën e Kombeve. Dhe rumunët kanë paralajmëruar se do të ankohen në CAS.

"Federata Rumune e Futbollit njofton se do ta sfidojë në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv vendimin e marrë nga UEFA pas



incidenteve që ndodhën në ndeshjen Rumani - Kosovë, e zhvilluar më 15 nëntor 2024 në National Arena në Bukuresht. Loja nuk përfundoi në fushë pasi ekipi mysafir refuzoi ta vazhdonte lojën, më pak se dy minuta pa përfunduar ajo, në

lojën shtesë. Referi u detyrua ta përfundonte lojën pasi priti rreth një orë, gjatë së cilës ekipi rumun qëndroi në fushë. Federata e Futbollit e Rumanisë thekson se tifozët rumunë e kanë pasur një sjellje të civilizuar gjatë lojës dhe ata u provokuan. Ka shumë prova në këtë drejtim. Përmes kësaj qasjeje, Federata e Rumanisë dëshiron ta mbrojë imazhin e futbollit rumun dhe të luftojë për respektimin e parimeve të "fair-play", shkruan në deklaratën publike të Federatës Rumune. Presidenti i Federatës së Futbollit

të Rumanisë, Razvan Burleanu, dënimin që e morën rumunët e konsideron të rëndë dhe atë të Kosovës të lehtë. "Ne konsiderojmë se gjobat janë të larta. Kosova e ka shkelur parimin më të rëndësishëm në futboll, që ndeshja të luhet në fushën e blertë. Sidoqoftë, ekipi i Kosovës nuk u sanksionua. Në vend të kësaj, ne morëm gjoba dhe një sanksionim shumë të lartë", ka deklaruar kreu i futbollit rumun. Federata e Futbollit e Kosovës është gjobitur 6 000 euro për sjelljen e ekipit.

Ademi paralajmëron zbarkimin e legjendave botërore në Prishtinë

Prishtinë, 3 dhjetor - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka paralajmëruar që së shpejtë në Prishtinë mund të zbarkojnë legjendat e futbollit botërorë, duke organizuar kështu një ndeshje miqësore ndërmjet legjendave të FIFA-s dhe UEFA-s. Ai në rrjetet sociale ka bërë me dije se është takuar me disa

legjendat e futbollit botëror, në mesin e të cilëve edhe legjenda e Holandës, Youri Djorkaef, për të cilin ka thënë se ai ka pranuar të jetë pjesë e asaj ndeshje. "Kënaqësi të jem në mesin e legjendave të futbollit, Youri Djorkaef dhe Houssine Kharja. Diskutuam rreth idesë që me rastin e inaugurimit të Kampit



Nacional të FFK-së të organizohet një ndeshje e veçantë mes yjeve legjenda të FIFA-s dhe UEFA-s. Një ndeshje e tillë do të bashkojë emra të mëdhenj të futbollit botëror në kryeqytetin tonë dhe do të shërbejë edhe si promovim për vendin tonë. Djorkaef e mirëpriti këtë ide dhe u pajtua që ta

përfshijë atë në programin e tyre", ka thënë Ademi. Ai ka shtuar se data e kësaj ndeshje nuk është përcaktuar ende dhe se është e varur nga ecuria e përfundimit të punimeve në kamp. "Data e këtij eventi të përcaktohet ndërkohë, pasi gjithçka varet nga ecuria e përfundimit të punimeve në kamp", ka shtuar Ademi.

Ismajli në formacionin e muajit në Serinë A

Empoli, 3 dhjetor - Ardian Ismajli është një nga lojtarët më të spikatur në Serinë A këtë sezon. Mbrojtësi i Shqipërisë vazhdon të mahnitë me paraqitjet e tij, me fanellën e Empolit. Ismajli falë formës së

mirë është zgjedhur në formacionin më të mirë të muajit nëntor në Serinë A nga faqja e statistikave "WhoScored". Vlerësim i rëndësishëm për shqiptarin që vjen në një kohë kur emri i tij përflitet në klube të

mëdha si Inter, Fiorentina, Juventus dhe Napoli. Qendërmbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë këtë sezon ka spikatur tek Empoli në duelet që ka pasur me sulmues me peshë si Lukaku apo Vlahović. Edhe pse

e ka mohuar, në muajin janar mund të vijë dhe çasti për ta bërë hapin e madh në karrierë. Formacioni: Caneseccchi, Ismajli, De Vrij, Bastoni, Orsolini, Reijnders, K. Thuram, Zaccagni, Lookman, Kean, M. Thuram.



Tjetër disfatë për lakersat, Bostoni triumfon ndaj Miamit

BOSTON, 3 DHJETOR - Bostoni fitoi me rezultat 108-89 ndaj Miamit në ndeshjen e radhës në NBA, duke mbrojtur vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Mungesa e Butlerit, i dëmtuar, ndikoi te Miami, ndërsa për Celticsin u dalluan

Browni me 29 pikë e Pritchardi me 25 pikë. Zhgënjeu skuadra e lakersave, që u mund me rezultat 109-80 nga Minnesota, në një ndeshje pa shumë histori. Davisi e Jamesi zhgënjyen për lakersat, ndërsa për vendasit

55 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Pa probleme fiton Atlanta, që mundi me rezultat 124-112 New Orleansin, sfidë ku shtatë lojtarë të Hawksit realizuan mbi 10 pikë. Ndërsa Chicago, falë 61 pikëve të trios

Vuqeviq-Gideey-Buzelis, mposhti me rezultat 128-102 Brooklynin. Rezultatet: Boston - Miami (108-89), Atlanta - New Orleans (124-112), Minnesota - Lakers (109-80), Chicago - Brooklyn (128-102).



Do të jetë trajner i Messit, paraqitet Mascherano: Projekt ambicioz, jam shumë i lumtur

MIAMI, 3 DHJETOR - Pasi ka kaluar disa vjet në krye të ekipeve të rinjve të Argjentinës, Javier Mascherano ka vendosur ta pranojë ofertën e Inter Miamit, që disa ditë më parë i besoi drejtimin e ekipit të parë. Ish-mesfushori ka shprehur mendimet dhe ka shpjeguar arsyet që e çuan ta mbyllë ciklin me "Albicelesten" dhe të transferohet në Shtetet e Bashkuara: "Jam shumë i lumtur që jam këtu. Për mua është një sfidë e madhe. Jam shumë i emocionuar dhe mezi pres ta nis punën në vitin 2025". Mascherano do të ribashkohet me ish-shokët e tij të skuadrës (Messi, Suarez, Busquets dhe Jordi Alba), të cilët do ta ndihmojnë të ambientohet: "Është një projekt ambicioz, me lojtarë të njohur, shumë prej tyre kanë qenë shokët e mi të



ekipit, por ka edhe shumë talente të reja nga Akademia, të cilat i konsideroj thelbësorë për të ndërtuar diçka të rëndësishme". Mascherano do të zëvendësojë Gerardo Tata Martinon, i cili u largua nga klubi për "arsye personale", dhe ka firmosur një kontratë deri në

fund të vitit 2027. David Beckham, pronar i Inter Miamit, për emërimin e Mascheranos ka deklaruar: "Jemi shumë të emocionuar që e mirëpresim si trajnerin tonë. Ka qenë një nga lojtarët më të mirë në botë dhe është një trajner me përvojë".

E shantazhoi familjen e Schumacherit, nis hetimi ndaj ish-truprojës së tij

BERLIN, 3 DHJETOR - Detaje të reja janë shfaqur rreth komplotit të shantazhit prej 14 milionë eurosh mbi Michael Schumacherin dhe familjen e tij. Policët gjermanë kanë nisur hetimet ndaj truprojës së legjendës së Formula 1 dhe dy të tjerëve që janë akuzuar për kërcënime ndaj familjarëve të ish-pilotit. Një nga njerëzit që dyshohet se është përgjegjës për komplotin e pëshirë është ish-truproja e Michaelit, i njohur si Markus F. Ai u lejua brenda rrethit të brendshëm të famshëm të Schumacherit për më shumë se tetë vjet, pasi gruaja e Michaelit, Corinna, ndjeu se ai ishte një ndihmës i besuar. Në fillim të këtij viti marrëdhënia ra në mënyrë



drastike pasi Corinna u detyrua ta pushonte Markusin nga puna për shkak të ndryshimeve në planin e kujdesit të bashkëshortit të saj. Kjo dyshohet se e bëri atë të ndërje keq dhe filloi të hartonte një plan për ta zhvatur familjen Schumacher, raporton "MailOnline". Markus kishte qasje në informacione private

rreth shëndetit dhe mirëqenies së shtatë herë kampionit të botës dhe besohet se kishte filluar të komplotonte për t'i zbuluar të gjitha në dark-web. Corinna është siguruar që shëndeti i bashkëshortit të saj 55-vjeçar të jetë një sekret i ruajtur që nga aksidenti i tij në vitin 2013. Plani i prishur i Markusit e pa atë të vidhte 1 500 dosje sekrete nga shtëpia e familjes Schumacher. Ky material i ndjeshëm besohej se ishte ngarkuar në katër USB dhe dy disqe në ditët para se Markus të lirohej. Përmbajtja përfshinte foto, video, lista me ilaçe, madje edhe dosjen e pacientit të Schumacherit, raporto "BILD" në korrik.

SHKURT

Bytyqi dhe Dellova në formacionin e javës në Bullgari

Dy futbollistët e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Zymer Bytyqi dhe Lumbardh Dellova, janë përfshirë në ekipin ideal të javës në Bullgari. Dyshja "dardane" shkëlqeu në fitoren e CSKA Sofjes në fundjavën që shkoi. Gjiganti bullgar triumfoi në udhëtim te Heber Pazardzhik me rezultat 1-0, ndërsa dyshja ishte më e vlerësuar në fushën e blertë. Bytyqi e mori notën më të lartë, 7,9, ndërsa me paraqitje solide u shqua edhe ish-futbollisti i Ballkanit, Dellova, i cili e mori notën 7,7. Dhe këto paraqitje të tyre u vlerësuan nga faqja e specializuar për vlerësimin e lojtarëve "Sofascore". Ata u përfshinë në formacionin e xhiros së 17 të ligës elitare në Bullgari.

Transferimi i Xhakës te Leverkuseni ishte afër dështimit

Gazeta e njohur gjermane "Kicker" ka zbuluar se Bayer Leverkuseni ishte afër t'i humbiste shërbimet e Granit Xhakës në verën e vitit 2023. Marrëveshja pothuajse dështoi për shkak të mosmarrëveshjeve financiare, por drejtori menaxhues, Simon Rolfes, ishte vendimtar në transferimin e mesfushorit te Bayer Leverkuseni. Pastaj, Granit Xhaka iu bashkua Bayer Leverkusenit për 15 milionë euro nga Arsenali dhe u kthye në një lider të klubit gjerman. Ndikimi i tij në suksesin e madh të klubit që në vitin e parë ishte i jashtëzakonshëm, ndërsa Bayer Leverkuseni dominoi në futbollin gjerman, duke fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Gjermanisë. Ata shkuan edhe në finale të Ligës së Evropës ku pësuan humbje nga Atalanta, që ishte e vetmja atë vit. Mesfushori nga Kosova nuk ka humbur asnjë minutë në Bundesligë këtë sezon, ndërsa ai është ende një nga lojtarët më të rëndësishëm të Bayer Leverkusenit. Ai me Leverkusenin ka kontratë deri në vitin 2028.

Skënderbeu zyrtarizon trajnerin e ri Ernest Gjoka

Ernest Gjoka merr drejtimin e Skënderbeut. Njoftimi zyrtar ka ardhur nga vetë klubi korçar, që ka bërë me dije emërimin e teknikut kryeqytetas. Gjoka do të pasojë në stol Ivan Gvozdenoviq, i cili u largua pas humbjes në kampionat ndaj Laçit. 58-vjeçari merr drejtimin e korçarëve dhe do ta bëjë debutimin ndaj Tiranës, në sfidën e planifikuar për t'u luajtur këtë të enjte. "Ernest Gjoka zyrtarisht bardhekuq! Tekniku Ernest Gjoka ka arritur marrëveshjen me klubin dhe është zyrtarisht trajner i Skënderbeut. Menjëherë pas prezantimit, Ernest Gjoka do t'i nisë përgatitjet për takimin e radhës ndaj Tiranës në stadiumin 'Skënderbeu'. Mirë se vjen, Ernest Gjoka!", thuhet në njoftimin e klubit. Gjoka e nje mirë kampionatin shqiptar, pasi ka drejtuar ekipe si Vllaznia, Kukësi, Flamurtari dhe Kamza, ndërsa ka qenë edhe në stolin e Shkupit e Shkëndijës së Tetovës, në Maqedoninë e Veriut. Skënderbeu mban aktualisht vendin e nëntë me 13 pikë, po aq sa edhe Bylis i vendit të fundit.

Davies befason të gjithë, qëndron në Bayern

Askush nuk e priste një lajm të tillë, por një media serioze në Gjermani si "Sport1" duhet marrë në konsideratë: Alphonso Davies nuk do të largohet nga Bayerni.

Pavarësisht se për të Real Madridi ka shfaqur interes shumë konkret, pa përjashtuar edhe Barcelonën, kanadezi ka vendosur ta rinovojë kontratën në "Allianz Arena".

Kontrata e tij aktuale në Mynih skadon në fund të sezonit dhe mund të largohet, nëse do, me parametra zero më 1 korrik 2025. Ai po joshet muajt e fundit nga

oferta e "Los Blancos". Gjithsesi, "Sport1" raporton se mbrojtësi i majtë ka ulur kërkesat e tij për pagën dhe bonuset, duke pranuar ofertën që Bayerni i ka bërë muaj

më parë. Pritet që Davies ta hedhë firmën para Krishtlindjeve. Ky lajm tregon se Bayerni nuk i lëshon lojtarët kollaj, por as nuk trembet kur yjet duan paga të larta.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Faton Fejzullahu me nr. të protokollit 7118/23 të datës 05.12.2023 për parcelën kadastrale 00139-13, që ndodhet në Fshatin turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri" në Komunën e Prizrenit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e "Objektit për banim – turizëm fshatar" në Fshatin Turistik në Prevallë të Komunës së Prizrenit.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.11.12.2024 në: dkp.mmp@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:	
Kushtet Ndërtimore të propozuara	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Tokë ndërtimore	
b. Vija rregulluese.	m'
c. Vija e ndërtimit.	1.0 m 3.0 m 9.80 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	h=10.15m' d=9.8m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	h=10.15 m' d=9.60m d=2.01 m d=1.00m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	20 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	80 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	20 %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	-
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Gurë, dru dhe tullë
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Noli Dina shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Luan Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Blendi Beka shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikatën e Shkollës së Mesme "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LËKARSKA KOMORA KOSOVA

THIRRJE PUBLIKE

TRAJNER PËR MBAJTJEN E TRAJNIMIT NGA LËMIA E ULTRASONOGRAFISË SË ABDOMENIT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E DRENASIT, GJILANIT DHE OBILIQIT

Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtrojnë veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Përshkrim i shkurtër i qëllimit të projektit

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Drenasit, Gjilanit, Obiliqit dhe Odës së Mjekëve të Kosovës, Nëntor 2024, për t'i mundësuar stafit të institucioneve shëndetësore në komunën e Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit, të ofrojë shërbime cilësore për pacientët, bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikave më të mira mjekësore, Oda e Mjekëve të Kosovës bën thirrje për Trajnerët të cilët do të ofrojnë trajnime në ultrasonografi si ndihmesë në diagnostifikim klinik si dhe diagnostifikimin diferencial klinik.

Objektivat e angazhimit dhe rezultatet e pritura

Objektivi i këtij angazhimi të trajnerëve është të sigurojë një program trajnimi për personelin mjekësor në institucionet shëndetësore në komunën e Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit në fushën si në vijim:

- Ultrasonografia e abdomenit

Trajnimet priten t'u ofrojnë mjekëve aftësi në përdorimin e ultrasonografisë në funksion të diagnostifikimit klinik si dhe diagnostifikimin diferencial klinik.

Trajnimet duhet të rrisin shkathësitë e stafit të përzgjedhur për të punuar në departamente të ndryshme të sektorit parësorë, si dhe do të mundësojnë për të mësuar më shumë rreth cilësisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Metodologjia

Trajnerët e përzgjedhur do të punojnë ngushtë me stafin e departamenteve relevante. Institucioneve shëndetësore të Komunës së Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit dhe do të ofrojnë trajnime në formë të:

- Trajnimeve në punë
- Seminareve/Punëtorive

Pritshmëritë

Nën udhëzimin e përgjithshëm të OMK-së dhe të Departamentit për Shëndetësi të Komunës së Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit dhe në bashkëpunim me ekipin trajneri i angazhuar pritet të:

- Përgatit module të trajnimit
- Propozojë afatin kohor të sesioneve të trajnimit
- Vlerësojë proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentet përkatëse brenda institucioneve shëndetësore në komunën e Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit
- Mbështet stafin për të përpunuar protokollet dhe udhëzimet e nevojshme
- Së bashku me trajnuesit, të përpilojë Procedura Standarde të Operimit
- Përgatit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve

Trajneri do të punojë drejtpërdrejt me mjekët e departamenteve përkatëse të institucioneve të mjeksisë familjare të Komunës së Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit. Megjithatë, për të kryer me sukses detyrat e mësipërme, ai/ajo do të punojë ngushtë me ekipet e menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe do të sigurojë raporte mujore që përmbledhin progresin dhe arritjet. Eksperti është i detyruar të përgatisë raporte javore të progresit, të cilat do t'u dërgohen për miratim menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe Kryetarit të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Kohëzgjatja

Fillimi: Dhjetor 2024

Koha e parashikuar e punës: 30 ditë brenda 3 muajve

Hapi 1	Përshkrimi i aktivitetit	Nr. ditëve	Vendi
1	Përgatit dhe prezanton përmbajtjen e moduleve të trajnimit	2	Vend i pacaktuar
2	Organizon dhe zbaton sesione trajnimi - në punë dhe sesione trajnimi on-line	20	Në një vend të caktuar
3	Kryen një vlerësim për të rishikuar proceset dhe protokollet ekzistuese në departamentin përkatës	4	Vend i pacaktuar
4	Harton udhëzime dhe protokolle për përdorim	4	Vend i pacaktuar
Total		30	

Kualifikimet dhe përvoja

- Diplomë universitare në Mjekësi;
- Specializimi;
- Niveli akademik paraqet përparsi;
- Leje pune dhe licencë nga institucionet përkatëse profesionale;
- Minimumi 10 vjet përvojë në departamentet përkatëse të specializuara;
- Certifikata nga trajnimet e vijara në fushën përkatëse;
- Aftësi të forta ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit verbal pedagogjik dhe në të shkruar dhe përvojë e demonstruar në punën me ekipe të ndryshme;
- Njohës i TI-së,dhe
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe angleze në të shkruar dhe në të folur paraqet përparsi.

Dokumentet dhe procedura për aplikim:

- Kopja e diplomave
- Kopja e Certifikatës së Licencimit nga institucioni përgjegjës;
- Kopja e certifikatave
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të trajnimit përkatës dhe mbajtjen e trajnimeve;
- Referenca nga organizimi i trajnimeve të ngjajshme
- Një letër që përfshinë ekspertizën dhe përvojën në fushën e mbajtjes së trajnimeve në njërin nga fushat e kontratës;
- Curriculum Vitae (CV), dhe
- Propozim financiar
- Certifikata e regjistrimit nga ARBK(vlenë për kompaninë vendore)/certifikata e numrit fiskal(vlenë për ofertuesit individual)
- Certifikata e TVSH-së (vlenë për kompaninë vendore)

Propozimi financiar* *Kërkesa financiare duhet të jetë e detajuar për secilën punë që do të realizohet, këtu duhet të përfshihet, mbajtja e trajnimeve, shkrimi i raporteve dhe një plan tentativë i punës;

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë në formë fizike në zyrat e Odës së Mjekëve të Kosovës, adresa QKUK, Instituti A, Kati III, 10000, Prishtinë,për Trajner/e për mbajtjen e trajnimit nga lëmia e ultratingullit në institucionet shëndetësore në komunën e Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit apo edhe.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 06 Dhjetor 2024, ora 16:00. Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen.

Kompania Regjonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Ustanovljava Društva
"PASTRIMI" sh.a. d.d.
Nr.br. 7450 dt. 03.12.2024
Priština - Priština



KOMPANIA REGJONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve me nr. të protokollit 7396 të datës 29/11/2024 për inicihimin e procedurës së rekrutimit për shpalljen e konkursit publike për punë dhe detyra specifike dhe me Vendimin e datës me numër të protokollit 7413 të datës 02/12/2024, Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës me detyra specifike

Titulli i vendit të Punës:	Kontabilist i certifikuar në KRM "Pastrimi" SH.A
Nr. i kërkuar:	Një (1) pozitë, në Selinë e Kompanisë
Numri i Referencës:	KJ/20/2024
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli VII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të caktuar

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Analizon pozicionet e pasqyrate financiare;
- Identifikon gabimet e mundshme të regjistrimeve në kontabilitet dhe ndihmon në korigjimin e tyre;
- Ofron rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e punës në kompani;
- Ndihmon ekipin në kontrollimin dhe deklarimin tatimor;
- Përgatit pasqyrat financiare sipas standardave të kërkuara;
- Kryen punë dhe detyra, për të cilat autorizohet nga Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtares Kryesor Financiar dhe i Tesisarit;
- Për punën e tij i përgjigjet ZKFTH-së.

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të zotërojë të paktën një gjuhë zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën;
- Të kalojë me sukses procedurën e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në Ekonomik, Certifikatë si Kontabilist/e e Certifikuar;
- Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 3 vite në Kontabilitet.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomës së fakultetit nga Institucionet Arsimore	✓
Certifikatë e Kontabilitetit	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet dorëzohen në Arkivin e KRM "Pastrimi" SH.A. në adresën rr.Tahir Zajmi nr.5, Priştinë.

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 04.12.2024 deri me datën 12.12.2024.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (60) pikë;
- Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (30) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, tačnije člana 8., na osnovu Odluke Upravnog odbora br. Protokol 7396 od 29.11.2024. godine o pokretanju postupka zapošljavanja radi objavljivanja javnih konkursa za određena radna mesta i zadatke i Odlukom od 02.12.2024. godine, izvršni direktor RPO "PASTRIMI" SH. A, proglasi:

JAVNI KONKURS

Da popunite radno mesto sa određenim zadacima

Naziv posla:	Ovlašćeni računovoda U RPO "PASTRIMI" SH. A
Potrebna br. Referentni broj:	Jedna (1) pozicija, u sedištu kompanije KJ/20/2024
Mesečni koeficient/plata:	Nivo VII
Trajanje ugovora o radu:	Sa fiksnim vremenom

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Analizirati pozicije finansijskih izveštaja;
- Identifikujte moguće računovodstvene greške i pomozite im da ih ispravite;
- Daje preporuke za poboljšanje efikasnosti rada kompanije;
- Pomaže timu u reviziji i poreskoj prijavi;
- Priprema finansijske izveštaje u skladu sa potrebnim standardima;
- Obavlja poslove i poslove ovlašćene od strane izvršnog direktora i glavnog finansijskog direktora i trezora;
- On odgovara na svoj rad GFDT.

2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- da bude državljanin Republike Kosovo,
- da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- Ne postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne povrede u javnoj ustanovi;
- Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- Uspešno proći procedure prijema utvrđene zakonom.

3. Opšti formalni zahtevi

- Potrebno obrazovanje:** visoka ekonomska sprema, sertifikat ovlašćenog računovode;
- Potrebno radno iskustvo:** Najmanje 3 godine u računovodstvu.

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopija diplome fakulteta iz obrazovnih institucija	✓
Sertifikat o računovodstvu	✓
Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Dokazi o obuci i kursevima (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, ne starije od 3 meseca	✓

6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RPO "PASTRIMI" SH.A.

Sve prijave se šalju u Arhivu "PASTRIMI" RPO, na adresi RR. Tahir Zajmi No.5, Priština.

7. Tačan datum i vrijeme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 04.12.2024. do 12.12.2024. godine.

Poslednji put prijema aplikacija je 4 posle podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi vrednovanja.

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu CV-a, pismenog i intervjuškog testa (usmeni test).

- CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (60) bodova;
- Intervju (usmeni test) se ocenjuje do dvadeset (30) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvaren najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Preliminarna faza verifikacije prijave do 7 dana;

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervju do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

